



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulv: "Zhan D'Ark". Nr. 2
Tirana – ALBANIA

Tel: + 355 4 380 300
+ 355 4 380 333
Faks: + 355 4 379 826

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
Web-site: www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 271/1 Prot.

Tiranë, më 20/ 11/2008

Lënda: *Dergohet Raporti i veçantë “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.”*

Drejtuar: **Kryetares se Kuvendit te Shqiperise**
Zj. Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

Tiranë

E nderuara Znj. Kryetare e Kuvendit!

Raporti i veçante Nr.3 qe po ju paraqesim eshte nje sinteze e perpjekjeve te vazhdueshme te Institucionit te Avokatit te Popullit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Fëmijëve, per te sensibilizuar organet shteterore dhe opinionin publik rreth gjendjes se fëmijëve në vendin tone, si dhe për të bërë rekomandime per përmiresimet që duhen bërë në këtë fushë të rëndësishme.

Ky raportim bëhet në përmbushje të detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore, si dhe per te vene ne zbatim detyrat e lena nga Rezoluta e Kuvendit të Shqiperise per te prezantuar gjate vitit tematika te rendesishme të gjendjes së të drejtave të njeriut në formën e Raporteve te Posaçme.

Paraqitja e ketij Raporti bazohet ne nenin 63, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe ne nenin 27 te Ligjit Nr.8454 date 04.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, te ndryshuar, ku thuhet se:

“Perveç raportimit ne kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund te raportoje para Kuvendit me nismen e tij ose me kerkesen me shkrim te

Kryetarit te Kuvendit ose te nje grupi deputetesh. Kryetari i Kuvendit vlereson nese ky raportim do te behet:

- a. ne seance plenare;*
- b. me shperndarje te raportit;*
- c. ne komisionet e perhershme te Kuvendit;*

Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport”.

Referuar sa me lart, do te sugjeronim që ky Raport i veçantë të shqyrtohet në një seancë të vetme me pjesëmarrjen e deputetëve të të dy Komisioneve të përhershme: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit te Punes, Çështjeve Sociale dhe Shendetësise.

Besojmë se Kuvendi i Shqiperise do ta konsiderojë dhe perdore kete Raport te veçante si mjet, i cili do te bëjë të mundur njohjen dhe marrjen e masave te duhura per te permiresuar sa më shumë standartet e realizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, sidomos duke krijuar një Ombudsman të veçantë për fëmijët, apo caktuar një Komisioner brenda institucionit të Avokatit të Popullit.

Lutemi që pasi të vendosni se si dhe para kujt do të shqyrtohet ky Raport, të njoftohemi për t’u paraqitur.

Më lejoni me këtë rast të vë në vëmendjen Tuaj se më datën 23.05.2008 ju kemi dërguar Raportin e veçantë nr.1 “Për botimin në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar”, dhe më datën 03.06.2008 Raportin e veçantë nr.2 “Për gjendjen e shëndetit mendor në Republikën e Shqipërisë”.

Deri tani nuk jemi njoftuar zyrtarisht për mënyrën e shqyrtimit të tyre.

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Ermir DOBJANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



RAPORT I VEÇANTE Nr.3

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje
të të drejtave të fëmijëve**

2008

I- Objekti dhe qëllimi i Raportit të Veçantë “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”

Fëmijët kane nevoja te posaçme dhe si rrjedhojë si individë ata kane statusin e tyre. Ata nuk janë produkt i shtetit, ashtu sikurse për gjithçka nuk janë vetëm në posedim te prindërve te tyre. Për këtë arsye, shteti dhe shoqëria e kanë për detyrë që t’i njohin kërkesat dhe te drejtat e tyre, si të drejta të individëve të veçantë.

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të Drejtat e Fëmijës” është konventa më e ratifikuar në të gjithë botën dhe përbën pikën më të gjerë të referencave ligjore dhe politike për çështjet e të drejtave të fëmijës.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë më 28 Shkurt te vitit 1992. Si rrjedhojë të gjitha institucionet publike, te mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoritetet administrative ne vendimet e tyre duhet te kenë parasysh gjithmonë, si interesin me te larte, atë te fëmijës. Qe atëherë shume sfida janë tejkaluuar për Kuvendin, Qeverinë, institucionet e tjera shqiptare dhe shoqërinë civile. Fëmijët i ndjejnë me shume, si për mire, ashtu dhe për keq, pasojat e veprimeve ose mosveprimeve te qeverisjes. Pothuajse çdo ligj i Kuvendit apo çdo vendim i Qeverise, ne çdo fushe, ndikon tek fëmijët ne mënyrë direkte apo indirekte. Me siguri mund te themi se gjendja e fëmijëve, e edukimit dhe shëndetit të tyre është një barometër matës i saktë i ndryshimeve social ekonomike ne çdo shtet. Të mos harrojmë qe të drejtat e njeriut fillojnë me të drejtat e fëmijëve. Një shoqëri qe respekton të drejtat njerëzore të fëmijëve, brenda nje gjenerate e me tej, mund të behet një shoqëri qe respekton me rigorozitet të drejtat e njeriut në standardet më të larta si p.sh. në vendet nordike.

Keqtrajtimi i fëmijëve është sot një nder problemet me te mprehta me te cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare. Gjithnjë e me tepër po behet i pranishëm realiteti i hidhur i keqtrajtimit te fëmijëve ne forma te ndryshme brenda dhe jashtë familjes, duke filluar nga rrahjet, përdhunimet dhe deri tek vrasjet apo vetëvrasjet. Po kështu, Shteti shqiptar, te gjithë ne, nuk nderohemi dhe nuk duhet të na zërë gjumi derisa edhe një fëmije i vetëm do te vazhdoje të mos shkojë ne shkollë për shkak te ngujimit. Ndërsa është rritur përgjegjësia ndaj disa shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, kryesisht nga komuniteti i OJF-ve, numri i fëmijëve të cilëve nuk u janë respektuar të drejtat është duke u rritur.

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton te drejtën e fëmijëve te kenë një mbrojtje te veçantë nga shteti. Fëmijëve u nevojitet një organizëm i posaçëm që të shumëfishoje zërat e tyre, në mënyrë që kërkesat dhe interesat e tyre të paraqiten në mënyrë sa më

efektive tek Qeveria dhe shoqëria si një e tërë. Me mungesën e mekanizmit të posaçëm koordinues dhe monitorues për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, Qeveria, komuniteti dhe OJF-të kanë kapacitete të kufizuara për të marrë masa më efektive, edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Meqenëse tashmë kanë kaluar më se tre vjet që nga koha e ngritjes së Nënseksionit për të drejtat e fëmijëve, Avokati i Populli e ndjen si detyrë dhe obligim ligjor, paraqitjen e këtij Raporti të posaçëm para Kuvendit të Shqipërisë për të bërë të njohur më në thellësi gjendjen e fëmijëve, veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe nevojën për krijimin e bazës së nevojshme ligjore për institucionalizimin dhe forcimin e punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ky synim i fundit arrihet ose nëpërmjet shtesave e ndryshimeve në ligjin “Për Avokatin e Popullit” ose nëpërmjet krijimit të një Institucioni të posaçëm të pavarur. Objektivi themelor i krijimit të një institucioni të veçantë e të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, është ngritja e standardeve të përmirësimit të të drejtave dhe shërbimeve për fëmijët, për të influencuar më shumë në politikat dhe praktikat e qeverisë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët si dhe të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit.

II- Përmbledhje e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, që në fillimet e punës së tij ka qenë tepër i ndjeshëm lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Ai ka synuar të japë një kontribut të veçantë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si me ane të trajtimit të ankesave individuale apo të hetimit me iniciativën e tij të rasteve të bëra publike, ashtu edhe me ane të shqyrtimit të legjislacionit dhe rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të nevojshme të tij.

Kështu duke marrë në shqyrtim statistikën vetëm për 3 vitet e fundit del se në vitin 2005 janë shqyrtuar nga Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve 39 ankesa apo kërkesa, nga shqyrtimi i të cilave 10 kanë marrë zgjidhje pozitive. Në vitin 2006 janë shqyrtuar 46 ankesa për shkelje të të drejtave të fëmijëve, nga të cilat 8 kanë marrë zgjidhje pozitive. Ndërsa në vitin 2007 kemi patur një rritje të ndjeshme të numrit të ankesave. Nga gjithsej 136 ankesa të trajtuara, 43 janë zgjidhur pozitivisht. Kurse për 9-mujorin e vitit 2008 kemi patur 61 ankesa, nga të cilat 20 janë zgjidhur pozitivisht, kurse 4 janë në shqyrtim.

Ankesat me të shumta dhe me serioze pre shkelje të të drejtave të fëmijëve kanë qenë ndaj komisariateve të policisë apo organeve të prokurorisë për shkelje të procedurave të hetimit; me pas nga numri vijnë

ankesat e bashkëshortëve ndaj ish-bashkëshortëve për probleme të fëmijëve ndaj zyrave të përbarimit, gjykatave, bashkive, sigurimeve shoqërore dhe mësuesve apo drejtuesve të shkollave.

Përsa i përket ankesave ndaj komisariateve të policisë, ato shpesh kanë qene tepër serioze dhe kanë patur të bëjnë me denoncimin e përdorimit të dhunës fizike e psikologjike nga oficeret e policisë. Kjo është një shkelje flagrante e të drejtës themelore për mbrojtje të veçante, që kanë sidomos fëmijët, të mbrojtjes nga dhuna dhe të çdo forme tjetër keqtrajtimi, si dhe të mbrojtjes së dinjitetit të tyre njerëzor. Ankesa të tjera për, dhe nga fëmijët, janë bere për heqjen e padrejthe të lirisë në rastet e shoqërimit në polici; për shkelje të rregullave të procedurës penale në rastet e pyetjes së fëmijës pa prezencën e prindit, të kujdestarit dhe të avokatit; për moszbatimin e rregullit të ndarjes së fëmijëve nga të rriturit në dhomat e paraburgimit dhe në burgje etj. Kështu vlen për t'u përmendur rasti i keqtrajtimit të një fëmije jetim nga organet e policisë në Sarandë, i bere publik qysh në vitin 2000. Trajtimi i suksesshëm dhe i paanshëm i këtij rasti beri që të merreshin masa disiplinore dhe penale ndaj oficerit të policisë që kishte shkelur ligjin, si dhe që ky rast të ndikojë në ndërgjegjësimin e policisë dhe të publikut për njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Rast tjetër është ai i të miturës J. D. nga Berati, e cila në datën 4 mars 1999, kur ishte vetëm shtate muajsh, u rrembye nga tre kriminele dhe gjate perpjekjes me policine, nga kjo e fundit fëmija plagoset në bark si dhe pas operacionit humbet këmbe dhe djathte. Pa u ndalur në kalvarin e familjes së foshnjës për ta kuruar atë në Itali, shpenzime këto që e kushtezuan familjen deri sa të shiste shtëpinë dhe gjithçka tjetër, mund të themi se nderhyrja dhe insistimi i Avokatit të Popullit beri të mundur ekzekutimin në vitin 2005 të vendimit gjyqësor për demshperblimin e viktimes në masën e 9.602.042 lekëve, në një kohë që ish Ministria e Rendit Publik deri në atë kohë refuzonte të zbatonte vendimin gjyqësor përkatës.

Ankesat ndaj zyrave të përbarimit kanë patur të bëjnë me mosekzekutimin sipas ligjit të vendimeve gjyqësore në rastet e zgjidhjes së martesës apo përfitimeve të tjera për fëmijët. E drejta prinderore që shkelet në këto raste ka pasoja të rënda psikologjike dhe shpesh të pariparueshme tek fëmijët. Zbatimi i ligjit dhe sjellja etike e përbaruesve në këto raste ka çaluar mjaft. Mjaft ankesa ndaj ish-bashkëshortëve që i adresohen indirekt zyrës së përbarimit, kanë patur të bëjnë me marrjen e padrejthe të fëmijës, mosdhënien e detyrimit për ushqim, shfrytëzimin ekonomik të fëmijës, duke cënuar kështu të drejtën e fëmijës për arsim, zhvillim, mirëritje, mbrojtje të veçante, etj.

Shqyrtimi dhe hetimi i ankesave nga, dhe për fëmijët, paraqet mjaft sfida dhe shpesh here është shumë i vështirë. Pavarësisht nga kjo, pasi ato janë shqyrtuar dhe janë bere verifikimet dhe sqarimet perkatese,

gjithmonë i është kthyer përgjigje ankuesit kur ankesa ka qenë brenda juridiksionit tonë ose ankuesit i është rekomanduar të ndjeke rruge të tjera ligjore për zgjidhjen e problemit të tij. Për rastet që janë bërë publike dhe raste të tjera të shkeljeve të rënda dhe flagrante të të drejtave të fëmijëve Avokati i Popullit, me iniciativën e tij dhe me pëlqimin e palës së interesuar ka kryer hetimet e nevojshme dhe sipas rastit, i ka bërë rekomandimet e duhura organit përkatës. Vlejnë për t'u përmendur rekomandimet e bëra për marrjen e masave disiplinore ndaj individëve, përfaqësues të organeve publike si p.sh. punonjës policie, oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë apo përmbarues dhe që, në përgjithësi, kërkesat tona janë marrë parasysh. Si rezultat, numri i ankesave të regjistruara në Institucionin e Avokatit të Popullit me objekt të drejtat e fëmijëve ka ardhur duke u rritur nga viti në vit.

Çdo vit në Raportet vjetore të institucionit tone të paraqitura në Kuvendin e Shqipërisë është trajtuar edhe puna që është bërë për ankesat dhe problemet e fëmijëve. Por në Raportet vjetore 2005, 2006 dhe 2007 kjo veprimtari ka zënë kapituj më vete.

III. Krijimi i Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe disa nga veprimtaritë kryesore të nënseksionit.

Avokati i Popullit deri në fund të vitit 2003, nuk kishte brenda tij ndonjë strukturë të veçantë që të merrej me të drejtat e fëmijëve. Shumë pak ankesa ishin marrë nga, apo në emër të fëmijëve. Kjo gjendje ishte e pritshme, për shkak se Avokati i Popullit nuk është krijuar si një strukturë e fokusuar vetëm për fëmijet. Nën-seksioni për të Drejtat e Fëmijëve (NDF), si embrion u krijua në Prill të vitit 2004 me anë të një marrëveshjeje mirëkuptimi mes Save the Children në Shqipëri dhe Zyrës të Avokatit të Popullit, marrëveshje e cila tashme ka perfunduar. Mandati i NDF-së ishte të “shërbejë si një avokat, një katalizator dhe një organ monitorues i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së OKB-se për të Drejtat të Fëmijëve (KDF), në Shqipëri”.

Detyra kryesore e këtij Nën-seksioni, në përbërje të Seksionit të Përgjithshëm, pranë Avokatit të Popullit ka qenë dhe është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Konventën e OKB-se për të Drejtat e Fëmijëve si dhe instrumenteve të tjera ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Më konkretisht veprimtaria e nënseksionit është përqendruar në:

- Mbikqyrjen e veprimtarisë së administratës publike si dhe të organizatave të tjera në shërbim të fëmijëve në territorin e Shqipërisë me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre.

- Trajtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

- Rekomandimin e përmirësimeve të legjislacionit ekzistues që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve.

- Promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe i veprimeve pozitive të organeve të administratës publike për mënyrën se si ushtrohen detyrimet e tyre ndaj fëmijëve.

- Ndergjegjesimin e shoqërisë shqiptare në përgjithësi për të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve, duke vënë sidomos në lëvizje mediat dhe duke bashkëpunuar në veçanti me OJF-të kryesore që kanë objekt të punës së tyre fëmijët.

Veprimtaria konkrete e Nënseksionit gjatë viteve 2005-2008, si pjesë organike e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, mund të përmbledhet në këto drejtime kryesore:

1. Projekti i perbashket 3 vjeçar me Save the Children.

Save the Children aplikoi në vitin 2004 pranë SIDA-s (Agjensisë Suedeze për Vendet në Zhvillim) për financimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe forcimin e këtij nënseksioni. Ky projekt u miratua në Janar 2006, për një periudhë kohore prej tre vjetësh dhe përfshinte shumë aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si rritje të ndergjegjesimit të opinionit publik për misionin dhe rolin e Nënseksionit; ndertim kapacitetesh dhe trajnim të burimeve njerëzore, asistencë teknike, mbështetje infrastrukturore, punë kërkimore, nderhyrje direkte në rast shkelje të të drejtave të fëmijëve, pjesëmarrje të fëmijëve, etj. Me konkretisht, disa nga aktivitetet me të rëndësishme të projektit ishin krijimi i një ambjenti vetëm për fëmijët pranë zyrës së Avokatit në Tiranë, ngritja e dy qendrave rajonale në Shkodër dhe Korçë për fëmijë; angazhim aktiv në hartimin e raporteve alternative për zbatimin e Konventës; zgjerim të stafit të Nënseksionit jo vetëm me juristë, por edhe me punonjës socialë, psikologë, sociologë, mjekë etj; ngritjen e një librerie për të drejtat e fëmijëve, bashkëpunim dhe koordinim i punës me institucionet e tjera shtetërore dhe shoqërinë civile, monitorim i legjislacionit aktual dhe propozime për ndryshim, etj.

Nënseksioni pati tre zyra; një pranë Zyrës Qëndrore të Avokatit të Popullit dhe dy zyra Rajonale, një në Shkodër dhe një në Korçë. Në çdo zyrë punonin dy juriste. Kështu, stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit, i ishin bashkangjitur pesë juriste të cilët u paguan nga Save the Children për vitet 2006-2007. Kurse për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 u paguan vetëm dy; një në Shkodër dhe një në Korçë nga buxheti i institucionit. Tashmë ato zyra janë mbyllur për mungesë buxheti. Embrioni i Nënseksionit vepron vetëm në zyrën qendrore në Tiranë, ku një ndihmëskomisioner merret vetëm me problemet e fëmijëve.

Gjate vitit 2006 Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve ka punuar kryesisht në drejtim të ngritjes së zyrave rajonale të NDF-se, plotesimit të stafit të tyre dhe promovimit të Nënseksionit në nivel kombëtar e rajonal.

Hapja e dy zyrave rajonale ne Korçe dhe Shkoder ka qenë një proces i vështirë bashkëpunimi me pushtetin vendor. Per kete jane marre kontakte te vazhdueshme me perfaqesuesit e pushtetit vendor te Korçes dhe Shkodres per të na dhënë ambjente te pershtatshme per zyrat. Keshtu ne Shkoder u morën ne perdorim dy ambjente prane Prefektures, ku njera sherbeu si zyrë për ekspertët dhe zyra tjetër u pajis me infrastrukturë miqësore për takimet me fëmijët. Ambjentet fëmimore ishin të parat te këtij lloji ne nje zyre shtetërore. Kjo zyre u përrua më 7 Nëntor 2005. Në Korçë patëm shumë vështirësi për zyrën, por falë bashkëpunimit me Prefekten e Korçës dhe ish Drejtorin e Përgjithshëm te Telekomit, u be e mundur edhe hapja e Zyrës Rajonale të Korçës, pranë godinës se Altelekomit më 22 Dhjetor 2005.

Funksionet kryesore te zyrave rajonale kanë qenë:

- te presin ankesat për shkeljet e te drejtave te femijeve;
- te monitorojne zbatimin e te drejtave te femijeve ne institucionet publike rajonale;
- te vendosin dhe forcojne bashkepunimin me aktoret kryesorë rajonal per te drejtat e femijeve dhe te ngenë nje sistem bashkepunimi te ndersjellte me OJF-të vendore që punojnë për fëmijët;
- te promovojne te drejtat e femijeve ne rajonin perkates.

Nga projekti me "Save the Children" u arritën këto rezultate:

1. Fuqizimi dhe kualifikimi i metejshe i kapaciteteve njerezore te Zyres se Avokatit te Popullit e ne veçanti te Nenseksionit per te realizuar nje mbrojtje me te mire te te drejtave te femijeve.

2. Grumbullimi i informacionit mbi praktikat me te mira ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

3. Studimi i legjislacionit shqiptar dhe puna parapërgatitore për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në favor të fëmijëve.

4. Nxjerrja e disa konkluzioneve, për t'i raportuar Kuvendit të Shqipërisë nevojën e forcimit të institucioneve shtetërore që merren me mbrojtjen e fëmijëve.

Hapja e ketyre zyrave rajonale lehtesoi procesin e ankimit te qytetareve edhe per çeshtje te tjera prane Institucionit te Avokatit te Popullit. Megjithe kohen e shkurter rreth 2-vjeçare te funksionimit te ketyre zyrave, pati nje numer ne rritje te ankesave te depozituara ne keto zyra rajonale.

2. Ne Janar 2005, ne Gjeneve, u zhvillua mbledhja e Komitetit te te Drejtave te Femijes qe mori ne shqyrtim Raportin fillestar te paraqitur nga shteti shqiptar per zbatimin e Konventes te te Drejtave te Femijes. Komiteti i dergoi Qeverise shqiptare vezhgimet perfundimtare dhe rekomandimet qe dolen nga kjo mbledhje. Aty percaktohej se rezultatet e reformave legjislative kanë sjellë përmirësim

të situatës së fëmijëve në vend. Ai gjithashtu u shpreh se një nga hapat më të rëndësishme të ndërmarra në vend ishte krijimi i një Nën-seksioni për të drejtat e fëmijëve pranë Avokatit të Popullit, për të cilin u tha se ka nevojë të pajiset me më shumë kompetenca dhe burime. Konkretisht në Rekomandimin e 13-të thuhet se: *“Komiteti e mirepriti informacionin lidhur me krijimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2000 dhe se fundi krijimin e Nën-seksionit për të Drejtat e Femijeve, brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Komiteti verën se ekzistojnë disa plane për zgjerimin dhe njohjen e Nën-seksionit të ri. Megjithatë, Komiteti shqetesohet pasi niveli i ndërgjegjesimit të femijeve në shërbimet e Zyres së Avokatit të Popullit mund të jete i ulët. Komiteti rekomandon që Shteti Pale të mundesoje pajisjen e Nën-seksionit të ri të Avokatit të Popullit me burimet e pershtatshme financiare dhe njerezore, për të siguruar funksionimin e tij të plote, duke përfshirë ndërgjegjesim me ane të fushatave dhe të lejoje marrjen e ankesave nga fëmijet dhe raportimin për zbatimin e të drejtave të femijeve”.*

Për realizimin e këtyre detyrimeve duhet bashkëpunimi i të gjitha organeve kryesore të shtetit. Prandaj më datën 16.03.2005 Avokati i Popullit i dergoi Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit një informacion lidhur me rekomandimet e Komitetit të të Drejtave të Femijes të OKB-së si dhe detyrat që i dalin Nënseksionit për të Drejtat e Femijeve, duke kërkuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Realizimi i detyrimeve që dalin nga rekomandimi i mesiperm ka qenë një nga prioritetet e Nënseksionit në punën e tij gjatë vitit 2005 e në vazhdim dhe perkon edhe me objektivat e përcaktuara në projektin e përbashkët midis Zyres së Avokatit të Popullit dhe Save the Children.

Në kuadrin e masave me karakter ndërgjegjësues që rekomandoi Komiteti i të Drejtave të Femijeve në Gjeneve, Avokati i Popullit Konferencën vjetore në dhjetor 2005 ja kushtoi pikerisht situatës së mbrojtjes së të drejtave të femijeve në Shqipëri dhe rolit të Nën-seksionit për këtë qëllim. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj Konferencë, ku mori pjesë edhe Kryetarja e Kuvendit, Zj. Jozefina Topalli (Çoba), ju derguan të gjitha institucioneve kryesore, puna e të cilave ndikon në politikën e mbrojtjes dhe zhvillimit të të drejtave të femijeve në vendin tonë. Po kështu përmendim që edhe në konkluzionet dhe rekomandimet edhe të disa Konferencave të tjera vjetore, që ka zhvilluar Avokati i Popullit si p.sh “Në mbrojtje të së drejtës së jetës” (2001), “Mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” (2003), “Në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar” (2006), etj, në fokus dhe një kapitull i veçantë i është kushtuar gjithmonë mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

3. Përmirësimi i ligjit organik “Për Avokatin e Popullit” dhe ndikimi i ndryshimeve në punën e Nënseksionit.

Si rezultat i përvojës 5 vjeçare (2000-2005) të Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave e lirive të individëve, u konsolidua mendimi se ishte i nevojshëm edhe amendimi (plotësimi) i ligjit “Për Avokatin e Popullit”, për të zgjidhur edhe problemet që kishin dalë gjatë zbatimit të tij në praktikë për të mbrojtur fëmijët. Kjo gjë tashmë është bërë realitet, pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit nr.9398, datë 12.05.2005 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Ndër të tjera, si më te rëndësishmë për t’u përmendur në këtë kontekst janë nenet 13 dhe 19/1 të këtij Ligji. Këto i dhanë frymëmarrje dhe mundësi më të mëdha veprimi sidomos Nënseksionit për të drejtat e fëmijëve, duke lejuar shqyrtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve edhe me iniciativë dhe pa pasur kufizimin për të marrë pëlqimin e palës së dëmtuar që, në çdo rast, me që është fëmijë, është shpesh e pa mundur për ta marrë. Gjithashtu neni 19/1 përmend institucionet shtetërore apo të administratës publike ku Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, si në burgje, dhoma paraburgimi, në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije. Pra janë përfshirë në mënyrë specifike edhe shtëpitë e fëmijëve, spitalet e tyre etj.

Duhet mbajtur parasysh se, ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e hetimeve dhe inspektimeve dhe në përfundim atë të rekomandimeve përkatëse.

4. Pjesëmarrja në punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit të kësaj Strategjie, miratuar me VKM nr.368, date 31.05.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për fëmijët”.

Nëpërmjet përfaqësuesit të tij në grupin e punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë, Nënseksioni ka mundur të identifikohet si një nga aktoret kryesore, që jo vetëm morën pjesë në hartimin e këtyre dokumentave, por që do të vazhdojë të luajë rol në implementimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit, të hartuara në përputhje me detyrat e vena nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i OKB, si dhe me objektivat e shtetit shqiptar për implementimin e Konventës të të Drejtave të Fëmijës. Në këtë Strategji, kur flitet për “Mekanizmat institucionale në nivel qëndror dhe vendor” thuhet konkretisht: - “Pranë zyrës së Avokatit të Popullit, në Prill të vitit 2004 është ngritur Seksioni (në fakt nënseksioni) i të Drejtave të Fëmijëve, si pjesë e Seksionit të Përgjithshëm të Ankesave. Misioni i këtij seksioni, i cili aktualisht ka dy

ndihmëskomisionerë, është të shërbejë si një avokat dhe trup monitorues i të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijës. Me një projekt të Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Save the Children, financuar nga SIDA-s (Agjencia Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar) po realizohet ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i këtij seksioni. Kjo projekt do të shtrihet në një periudhë kohore prej tre vjetësh dhe do të kërkojë ndërmjet të tjerash dhe ndryshime të ligjit aktual të Avokatit të Popullit, krijimin e zyrave rajonale, trajnime të stafit, ngritjen e një librerie për të drejtat e fëmijëve, punë studimore dhe kërkimore, ngritje të ndërgjegjësimit të opinionit publik për të drejtat e fëmijëve etj”.

5. Çështja e “fëmijëve të zhdukur” në Greqi

Avokati i Popullit, pasi mori njoftim nga një gazetë shqiptare, ka ndjekur me përparësi rastin me natyrë tepër komplekse dhe nderkombetare, të “zhdukjes” se rreth 500 femijeve shqiptare nga një institucion i kujdesit të femijeve në Greqi. Hetimet e Ombudsmanit Grek të zhvilluara me kërkesën tone konfirmuan se, në të vertete, një numër i madh femijesh, kishin ikur apo ishin marrë nga institucioni kujdestar “Agia Varvara” në Athinë ku ata ishin vendosur gjatë periudhës 1998-2002. Zyrtarisht ata konsiderohen të “zhdukur” sepse atyre në vitin 2002 nuk i dihej vendndodhja nga policia ose autoritete të tjera, në një kohë që mund të ishin në duar të trafikantëve etj. Fale ndjekjes hap pas hapi nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit kjo çështje fitoi përmasa nderkombetare dhe filloi ndjekja penale si në Shqipëri, ashtu dhe në Greqi. Veç kësaj është e rëndësishme të theksohet se duke patur parasysh këtë rast, Qeveritë e të dy vendeve firmosën në vitin 2006 një marrëveshje për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët e braktisur, (viktima të trafikimit) që gjenden në Greqi, të cilët duhen rikthyer të sigurtë në Shqipëri apo të sistemohen në vende të sigurta në Greqi. Kjo marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9544 datë 29.05.2006. Por për fat të keq, me sa jemi në dijeni, akoma ky ratifikim nuk është bërë nga Parlamenti Grek.

6. Fushata Sensibilizuese dhe parandaluese

Institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar një fushatë të gjerë sensibilizimi në shumë drejtime për njohjen dhe respektimin e të drejtave të femijeve. Kjo është pasqyruar jo vetëm në mediat elektronike dhe të shkruara, por dhe në korrespondencat tona nderinstitucionale. Duhet të kujtojmë se duke parë me shqetësim pjesëmarrjen e gjere të femijeve në fushatat elektorale para vitit 2005, para zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë që u zhvilluan më 3 korrik 2005, më 20.05.2005, në mjeshtet para godines se mbledhjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit beri një *Deklaratë për median*, me synimin e sensibilizimit të të gjitha forcave politike shqiptare për të mos përfshire femijet në mitingjet elektorale. Në këtë Deklaratë u theksua se nuk duhet

harruar qe femijet nuk kane pjekurine intelektuale, fizike apo mendore njesoj si te rriturit, dhe shpesh ata nuk e kuptojne qellimin e ketyre organizimeve apo mitingjeve. Prandaj mosha per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur eshte caktuar 18 vjeç e lart. Është pikërisht kjo mungesë e pjekurisë intelektuale të tyre arsyeja qe fëmijët kane nevojë për një mbrojtje te veçantë.

Mbrojtja e te drejtave te femijeve duhet te perbeje nje prioritet per te gjitha forcat politike. Por ne jo pak raste ne tubimet politike gjen shprehje gjuha e konfliktualitetit dhe akuzave respektive teper te renda. Prandaj në vend që fëmijëve t'u kultivojme tolerancen, nje fryme me te madhe mirekuptimi, humanizmin, shpirtin konkurues dhe ambicjet pozitive, në të gjitha mitingjet elektorale përçohet fort ndjenja e ndarjes dhe konfliktualitetit. Avokati i Popullit shpresonte ne mirëkuptimin e partive politike si dhe angazhimin e tyre per fushata sa me qytetare dhe me mesazhe shprese, por pa pjesëmarrjen e fëmijëve. Por për fat të keq forcat kryesore politike në vend vazhdojnë të shfrytëzojnë pjesëmarrjen e fëmijëve edhe tashmë që jemi në pragun e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009.

Veprimtaria e NDF ka qene prezente ne mediat kombetare dhe lokale. Specialistët e saj kanë qene të ftuar shpesh per te diskutuar ne TV Kombëtare dhe lokale për të drejtat e fëmijëve. Po keshtu jane publikuar artikuj ne gazetate e perditshme kombetare etj. Eshte punuar se bashku me agjencine e kontraktuar "Ashley and Holmes" per pergatitjen e dy spoteve publicitare informuese per NDF-ne. Njeri prej spoteve synonte informimin e femijeve dhe tjetri ate te te rriturve, për te drejtat e femijeve. Keto dy spote jane transmetuar nga data 15 Maj-15 Qershor 2007 si dhe ne Shtator 2007 ne mediat kryesore kombetare dhe lokale. Si rezultat i fushatës sensibilizuese, ka patur nje rritje te ndjeshme te numrit te ankesave për vitin 2007.

7. Monitorimi i shtypit dhe mediave televizive për respektimin e te drejtave te fëmijëve.

Ne kuadër te projektit te përbashkët me SIDA dhe Save the Children, u kontraktua Instituti i Medias Shqiptare për te zhvilluar monitorimin e medias se shkruar për pasqyrimin e te drejtave te fëmijëve ne media. Për këtë, u monitoruan per nje muaj 6 gazetate me numrin me te madh te kopjeve te shitura.

Ne përgjithësi, vërehej nje lloj njëtrajtshmërie përsa i përket larmisë se temave mbi fëmijët te pasqyruara ne gazetate e përditshme te monitoruara. Arsyeja kryesore per pasqyrimin e femijeve ne faqet e gazetave zakonisht ishte ndonje konference per shtyp ose raport i botuar nga ndonje organizatë vendase apo ndërkombëtare apo ndonjë krim i rëndë me përfshirje të fëmijëve. U konstatua se kishte nje mungese te theksuar te nismave nga vete gazetate per te pasqyruar me iniciativen e

tyre te drejtat e femijeve, me disa perjashtime te pakta. Gjithashtu keto gazeta nuk tregonin ndonje perpjekje per te ndjekur çeshtjet problematike me vone, pas botimit te raporteve për fëmijët.

Disa nga rekomandimet e nxjerra jo vetëm nga monitorimi, por edhe nga shqyrtimi i ankesave për të drejtat e fëmijëve janë:

- Gazetaret duhet te rrisin pasqyrimin e problemeve te femijeve ne media dhe ta zgjerojne ate edhe me analiza te gjendjes se te drejtave te femijeve;

- Gazetaret duhet t'i trajtojne femijet si gjithë njerezit e tjere dhe jo ne menyre paternaliste, sensacionale, viktimizuese apo shfrytezuese;

- Duke pasur parasysh gjithë kujdesin qe duhet treguar kur trajton femijet, gazetaret duhet te perpiqen te rrisin pranine dhe vizibilitetin e femijeve ne media;

- Gazetarët duhet te tregojnë vëmendje te veçante për gjuhën dhe termat qe duhen te përdoren, sidomos kur pasqyrohen krime dhe drejtësia per te mitur;

- Gazetaret gjithnje duhet te kene parasysh perkufizimin e interesit më të lartë që është ai i Fëmijës, kur marrin vendime per te intervistuar femijet dhe per te botuar informacion rreth tyre.

- Gazetarët duhet të respektojnë të dhënat personale dhe të ruajnë identitetin e fëmijëve, sidomos në kronikat e zeza.

8. Fuqizimi i bashkëpunimit me aktorët kryesorë të shoqërisë civile për te drejtat e fëmijëve.

Një nder objektivat e Nenseksionit ka qenë dhe eshte te vendosë ura bashkepunimi me OJF-te që kanë objekt kryesor fëmijët dhe te krijoje nje sistem referimi te ndersjellte per raste te ndryshme të shkeljes së të drejtave të tyre. Ne kete kuader janë zhvilluar takime periodike me OJF-te per te diskutuar mbi çeshtje e caktuara. Ne këto takime është bashkëpunuar sidomos me OJF-të kryesore qe punojne me, dhe per te drejtat e femijeve ne Shqiperi siç janë: Aleanca per Femijet ne Shqiperi, Amaro Drom, Amici dei Bambini, Qendra Bethany, CRCA, Cafod, Klinika Ligjore per te Miturit, ICMC, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Ndihmoni Jeten”, Parlamenti Rinor, QTMPKF, Save the Children, World Vision. Në veçanti Unicefi ka patur një bashkëpunim të frutshëm.

Ka patur shume raste ku NDF-ja, ka inicuar investigime dhe ka bërë rekomandime bazuar ne referimet e rasteve nga OJF-te. Megjithatë ky sistem referimesh duhet përmirësuar më tej. Gjithashtu duhet te punohet sidomos ne drejtim te mirë-koordinimit te çështjeve qe ngrihen. Veçse shpesh OJF-të ngurojnë t'i referojnë tek Avokati i Popullit ankesat apo shkeljet ndaj fëmijëve për shkak se duan që të justifikojnë punën e tyre para opinionit publik dhe në veçanti ndaj donatorëve të huaj.

9. Investigimi me initiative për problemin e mosregjistrimit te fëmijëve.

Organizata Cafod shprehu shqetësimin për ekzistencën e një numër të madh fëmijësh të paregjistruar. Sipas tyre ky fenomen është kryesisht i përhapur në zonat rurale dhe informale, si rrjedhojë e procedurave të ndërlikuara të parashikuara në ligjin “Për gjendjen civile” për regjistrimin e fëmijëve. Bazuar në këtë informacion, NDF-ja ndërmori hetime në zonen e Bathores, Bashkisë së Kamzës, Komunën e Zallherit dhe Babrrusë. Nga takimet e zhvilluara me Kryetaret e njësive vendore perkatese dhe punonjësit e zyrave të gjendjes civile rezultoi se në ato zona kishte një numër të konsiderueshëm fëmijësh të paregjistruar. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e procedurave të ndërlikuara ligjore për regjistrimin e fëmijëve të porsalindur nëse skadon afati 45 ditësh i regjistrimit të tyre. Prindërit e këtyre fëmijëve, shpesh si pasoje e mungesës së kulturës së duhur, të mos informimit dhe migrimit të brendshëm nuk kanë bërë në kohë regjistrimin e fëmijëve të tyre pranë zyrave të gjendjes civile. Vertetimi i lindjes së fëmijëve me anë të gjykatës është jashtë mundësive ekonomike të këtyre familjeve. Gjithashtu konstatuam se ishin të shumtë fëmijët e paregjistruar që u perkasin familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të cilat edhe janë më të rrezikuara ndaj trafikut të fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke marrë shkak nga këto konstatime, në Korrik 2006 i dergoi Ministrisë së Brendshme një rekomandim për disa ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile”. Sidomos u rekomandua që në çdo moment regjistrimi i fëmijës duhet të bëhet me akt administrativ, me lehtësi dhe pa shpenzime për prindërit. Përfundimisht rregullimet e propozuara janë bërë me ligjin nr. 9929 datë 09.06.2008.

10. Përsosja e legjislacionit për fëmijët.

Për fat të keq në Shqipëri nuk ekziston ende një përmbledhje unike që të përfshijë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të drejtat e tyre. Dispozitat që ekzistojnë në lidhje me fëmijët janë të shpërndara në shumë ligje të ndryshme dhe akte nënligjore.

Gjate 2006 u bë studimi krahasues i legjislacionit shqiptar për fëmijët me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Ky studim përfundoi më 2007 dhe bazuar në gjetjet e tij do të përgatiten edhe rekomandime konkrete për përmirësimet e legjislacionit.

Por në veçanti Zyra e Avokatit të Popullit ka paraqitur disa rekomandime para Kuvendit apo Qeverisë për përmirësim të legjislacionit që ka lidhje me të drejtat e fëmijëve. Ndër më kryesoret janë:

a- Rekomandimi për disa ndryshime në ligjin “Për gjendjen civile”, për të rregulluar situatën e mos regjistrimit të shumë fëmijëve, siç përmendëm më lart.

b- Rekomandimi drejtuar Komisionit për hartimin e Kodit Zgjedhor pranë Kuvendit të Shqipërisë, që në kapitullin e Përkufizimeve dhe Parimeve, në Nenin 3 ose në Nenin 5 të Kodit Zgjedhor, të shtohet

një pike e veçante, e përkufizuar si me poshtë: “Te ndalohej përfshirja/pjesëmarrja dhe angazhimi i fëmijëve nën 18 vjeç në takimet e partive politike”.

Si drejtues i një institucioni në fokusin e veprimtarisë të të cilit është mbrojtja e të drejtave të njeriut, deklaroj bindjen se të drejtat e fëmijëve duhet të qëndrojnë mbi interesat partiake dhe politikën e ditës. Prandaj do të vazhdojmë të insistojmë në aplikimin e këtij rekomandimi.

c. -Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Brendshme për çeljen e fondit financiar në organet vendore të policisë për pagimin e punonjësve social dhe avokateve mbrojtës për të miturit. Ky rekomandim është pranuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, e cila dërgoi një letër porosi në të gjitha komisaritet e policisë për të respektuar të drejtën e fëmijëve për të patur një avokat në momentin e shoqërimit. Ndërsa në lidhje me prezencën e psikologut, është rekomanduar që t’i kërkohet ndihmë shoqërisë civile, konkretisht OJF-ve që merren me fëmijët

IV- Domosdoshmëria e krijimit të një institucioni të veçantë për Fëmijët dhe çështjet ku duhet të fokusohet puna e tij

1. Për t’ju përgjigjur kërkesave të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës vitet e fundit, në të gjithë botën, janë ngritur organizma të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Prandaj në mjaft vende këto detyra ju janë caktuar me ligj institucioneve të veçanta të pavarura, që shpesh quhen Ombudsmanë për fëmijët. Por në disa vende kjo detyrë ju është caktuar krahas detyrave të tjera edhe institucioneve të Ombudsmanëve Kombëtare (të përgjithshëm).

Norvegjia është vendi i parë, i cili në vitin 1981 ka caktuar një Ombudsman të veçantë për të drejtat e fëmijëve. Zyrat e Ombudsmanëve për fëmijët në botë, përveç trajtimit të ankesave konkrete lidhur me të drejtat e tyre, punojnë edhe për promovimin e këtyre të drejtave, ashtu siç përcaktohet dhe në Konventën e OKB-së. Por terminologjia që përdoret për emërtimin e këtyre zyrave është e ndryshme. Ata quhen Ombudsman ose “Komisioneri për Fëmijët”, ose “Mediatori i fëmijëve” etj. Por mjaft vende evropiane kanë zgjedhur edhe modelin tjetër, të dhënies të kësaj detyre institucionit të Ombudsmanit, duke krijuar struktura të posaçme brenda tij.

Më poshtë po japim një Pasqyrë për organizimin e zyrave të mbrojtjes së fëmijëve në Evropë dhe emërtimet përkatëse

A. Institucione të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve

1. Norvegjia-Ombudsman for Children
2. Suedia-Ombudsman for Children and Young Persons
3. Finlanda-Ombudsman for Children

4. Danimarka-Danish Council for Children's Rights
5. Belgjika-General Delegate for Children's Rights
6. Austria-Ombudsman for Children and Youth
7. Islanda-Ombudsman for Children
8. Polonia-Ombudsman for Children
9. Irlanda-Ombudsman for Children
10. Lituania-Ombudsman for Children
11. Malta-Commissioner For Children
12. Franca-Defenseur des Enfants

B. Sektorë të veçantë brenda zyrave të Ombudsmanit, të drejtuara nga një zëvendësombudsman.

1. Hungaria
2. Spanja
3. Maqedonia
4. Greqia
5. Rumania
6. Sllovenia
7. Bullgaria
8. Mali i Zi
9. Ukraina
10. Portugalia

2. Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është strukturë e specializuar, por mbulon fusha të gjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai është marrë edhe me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, si nje zgjidhje ndaj problemeve dhe shqetësimeve që lidhen me mungesat në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vend. Por, **ne gjykojmë se Avokati i Popullit nuk ka gjithë burimet e nevojshme për të dhënë mbështetjen e duhur për fëmijët.** Prandaj krijimi me ligj të veçante i nje institucioni të pavarur për të Drejtat e Fëmijëve (Ombudsman apo Komisioner për Femijet), do të jete nje kunderpergjigje per një zgjidhje optimale për çështjet kryesore ku ka probleme me të drejtat e fëmijëve.

Krijimi i ketij institucioni të pavarur, i cili do të jete “garantues” i zbatimit të Konventes së të Drejtave të Femijes dhe do veproje për të promovuar të drejtat e Femijeve tek Parlamenti, Qeveria dhe shoqëria civile, do të ndikojë gjithashtu në politikën, duke krijuar forume ku të degjohet zeri i femijeve, duke ripare aksesin e femijeve në sistemin e ankimimit dhe për t’ju përgjigjur ankesave individuale. Që kjo nismë të ketë sukses për të sjellë ndryshime në shoqërinë shqiptare, burime njerëzore dhe financiare më të mëdha duhet të mobilizohen që të fuqizojnë veprimtarinë praktike qoftë të Avokatit të Popullit apo çdo

institucioni tjetër të posaçëm që mund të krijohet. Ky institucion duhet të ketë kapacitetin jo vetëm për të hetuar çënimet e të drejtave të fëmijëve dhe të japë zgjidhje për këtë çështje, por sidomos të bëjë bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët e tyre në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, nëpër shkolla, Universitete, qendra të banuara, në media, sipas një strategjie të detajuar, por edhe të mbështetur me burime njerëzore dhe financiare si nga buxheti i shtetit apo donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

Shtrohen pyetjet: Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e secilit nga këto dy modele? Cili është modeli më i përshtatshëm për Shqipërinë?

Së pari, çdo institucion i pavarur, i krijuar për monitorimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të jetë në përputhje me Parimet e Parisit, duke pasur parasysh statusin e veçantë të fëmijëve.

Bazat kryesore të “Parimeve të Parisit”, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara janë pavaresia e institucionit e garantuar nëpërmjet Kushtetutës dhe ligjit; kompetenca të gjëra për hetime eventuale të bazuara në standartet ndërkombëtare; sigurimi i burimeve të bollshme financiare të Institucionit dhe sigurimi i pluralizmit në përbërjen e stafit të institucionit. Veç këtyre parimeve një Ombudsman apo Komisioner për Fëmijet duhet të punojë për të garantuar që Kuvendi, Qeveria dhe çdo organ apo autoritet publik, që merr vendime lidhur me çështjet e fëmijëve, të mbajë parasysh interesin me të lartë të tyre, ashtu siç kërkon Konventa e OKB për Fëmijët.

Pra mbi këto baze institucioni për Fëmijet duhet:

- Të mbështesë fëmijet dhe të rinjtë në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe të punojë për të realizuar gjithmonë interesin me të lartë të tyre;

- Të ndermarre studime për politikën dhe për një kuptim e zbatim sa më efektiv të interesit me të mirë të fëmijes nga të gjithë.

- Të paraqesë rekomandime për Parlamentin, Qeverinë dhe të gjithë aktorët e tjerë lidhur me atë çka është me e mira për fëmijët dhe të rinjtë;

- Të presë e të shqyrtojë ankesa nga dhe për fëmijët, si nga ata vetë, ashtu dhe nga personat në moshe madhore lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Fushat ku mund të veprojnë institucioni i të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, mund të jenë mbrojtja e atyre fëmijëve që janë të ekspozuar ndaj kriminalitetit në rritje (duke përfshirë trafikimin), ndaj varfërisë, arsimimit të pamjaftueshëm, varësisë nga drogat, lypjes, dhunës dhe abuzimit seksual, punës së detyruar etj. Gjithashtu ky institucion do të kryejë analiza për të identifikuar arsyet bazë për mosfunksionimin e strukturave të autoriteteve publike në mbrojtje të fëmijëve si dhe do të rekomandojë zgjidhje për Parlamentin dhe Qeverinë kur marrin vendime që kanë të bëjnë me fëmijët.

Lidhur me zgjidhjen se cila eshte rruga me e mire e mbrojtjes se te drejtave te femijeve, krijimi i nje ***Ombudsmani apo Komisioneri të veçante per femijet*** apo i nje ***Seksioni të veçantë brenda Avokatit të Popullit***, gjykojme se është Parlamenti dhe Qeveria që duhet ta bëjnë vlerësimin.

Ne kemi mendimin se nisur nga interesi financiar, meqenese një pjesë e infrastrukturës eshte e ngritur dhe funksionon, eshte me pak e kushtueshme se sa te krijosh nje Ombudsman apo Komisioner te veçante per Femijet, Qeveria mund të pëlqejë që të krijohet një seksion brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Edhe Kuvendi mund të arsyetojë në të njëjtën mënyrë, plus edhe faktin se ky Seksion per të Drejtat e Femijeve ka një përvojë pune dhe e ka të gatshëm reputacionin nga Avokati i Popullit. Veç këtyre arsyetimeve, duhet të theksoj se pavarësisht zgjidhjes së Kuvendit, rritja e veprimtarisë në favor të fëmijëve do të kërkojë një staf të gjerë me specialistë jo vetëm juristë, por edhe të fushave të mjekësisë, psikologjisë, edukimit, mediave etj., që Avokati i Popullit nuk i ka, por pa të cilat nuk mund të ketë rritje të standardeve që synohen.

Avokati i Popullit mendon se rritja e vëmendjes ndaj çështjeve të të drejtave të fëmijëve, sidomos për raportet mes problemeve të fëmijëve dhe interesit të zyrtarëve publikë, për to është një nevojë urgjente. Me krijimin e Ombudsmanit (Komisionerit) për fëmijët, mund dhe duhet të besojmë së kushtet e përmirësuara të jetesës së fëmijëve e të të rinjve do të jenë akoma më në qendër të vëmendjes.

Ne rrugen per zbatimin e plote të Konventes dhe te te gjitha detyrimeve qe rrjedhin nga aktet nderkombetare, ***Ombudsmani i Femijeve*** do të luaje nje rol strategjik per:

- Promovimin e prioritetit sa me të larte të interesit të fëmijës dhe nje vizioni më të gjerë për problemet e femijeve, për shkak të fokusimit të problemeve me të cilat merret.

- Përmirësimi i qëndrimeve publike lidhur me fëmijët.

- Ndikimi ne ligje, politika dhe praktika duke ju drejtuar me rekomandime dhe propozime specifike Parlamentit dhe Qeverise.

- Promovim dhe koordinim i veprimtarisë të të gjitha mekanizmave qeveritare per çështjet me fëmijët ne te gjitha nivelet.

- Nxitje e përdorimit efektiv te burimeve për fëmijët.

- Nxitje e inkurajim i te drejtes se shprehjes se opinioneneve te fëmijëve dhe inkurajim i Qeverisë dhe publikut qe t'i kushtoje atyre vëmendjen e duhur.

- Përgjigje për problemet individuale dhe ankesat e fëmijëve, dhe kur është nevoja, te inicioje apo te mbështesë me ndihme ligjore fëmijët.

- Një përqendrim mbi fëmijët më të cënuar, që jetojnë në kushte të vështira, të diskriminuar dhe të nxjerrë në plan të dytë nga mungesa e burimeve dhe kushteve për një jetë me cilësi të mirë.

- Një identifikim aktiv i faktorëve dhe një kritikë më të fortë ndaj detyrimeve shtetërore dhe të OJF-ve, po ashtu edhe komuniteteve për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

- Koordinimi i përmirësuar dhe proaktiv mes Ombudsmanit (Komisionerit) dhe agjensive shtetërore si dhe organizmave të ndryshme që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, për një ambjent më përgjegjës mbi politikat si dhe për ndërhyrje të qëndrueshme të qeverisë për të drejtat e fëmijëve.

- Gjithashtu promovimi i pjesëmarrjes së fëmijëve shton vlerën ndaj suksesit të të gjitha iniciativave për të mbështetur fëmijët, si dhe do të bëjë të mundur që të dëgjohet zëri i tyre. Institucioni i posaçëm do të ketë njohuri me të thella mbi situatën e fëmijëve dhe të drejtave të tyre në vend dhe do përcaktojë më mirë veprimet që duhen marrë kur ka shkelje të këtyre të drejtave. Ketu përfshihen:

a. Studimet specifike mbi fëmijët në lidhje me çështje të ndryshme.

b. Sigurimin se një pjesë e rëndësishme e njohurisë së punës vjen nga vetë fëmijët.

c. Sigurimin e aktorëve kyç me informacionin e përshtatshëm mbi politikat dhe veprimet për të reflektuar një përjasje mbi të drejtat e fëmijëve ndaj të gjitha çështjeve që dëmtojnë fëmijët.

d. Analiza gjithpërfshirëse të situatës së të drejtave të fëmijëve në vend dhe faktorët e ndryshëm që influencojnë zbatimin e tyre, duke ndjekur parimet e KDF-së të Kombeve të Bashkuara.

e. Vlerësimi i mungesave në legjislacion, do të krijojë një bazë për pranimin e përgjithshëm publik të praktikave më të mira të të drejtave të fëmijëve.

Nepermjet ndryshimeve të nevojshme ligjore, organizimi i posaçëm për fëmijët do të pozicionohet të punojë më me efikasitet dhe me një mandat më të fortë për ta, duke u mbështetur më gjerësisht nga autoritetet qëndrore dhe lokale në të gjithë Shqipërinë.

Në një kuptim më të gjërë, të gjithë fëmijët në Shqipëri, të drejtat e të cilëve janë shkelur, do të përfitojnë. Perfitues do të jene mijëra fëmijë të cilët do të përfitojnë në mënyrë direkte dhe jo direkte me anë të ndërhyrjeve, apo përmirësimeve në legjislacion si edhe nëpërmjet rekomandimeve që do ndikojnë në mënyrë pozitive gjendjen për fëmijët në Shqipëri. Ombudsmani apo Komisioneri për Femijet dhe OJF-te në Shqipëri do të punojnë në partneritet për të përmirësuar mbrojtjen institucionale dhe kujdesin efektiv me të gjitha institucionet shtetërore, në dobi të interesit më të lartë të fëmijëve.

Prandaj ky Raport i veçantë duhet studiuar dhe diskutuar nga Komisionet parlamentare të përhershme dhe duhet t'i jepet një zgjidhje çështjes që Avokati i Popullit e gjykon shumë të rëndësishme, me interes shumë të lartë në favor të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë.